



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

(Specialist)

**Lloji i diplomës “shkenca ekonomike” “shkenca administrative”
Niveli minimal i diplomës “Diplome e Nivelit të Parë”**

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, VKM-së Nr.142 datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetëore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar ; si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, **Bashkia Mallakastër** shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

Specialist <i>Spektori i Tatim –Taksave, kategoria IV-B</i>	1 (një)
-------------------------------------------------------------	---------

Afati për dorëzimin e dokumentave për LEVIZJE PARALELE:	<u>23.01.2017</u>
Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL:	<u>27.01.2017</u>



Përshkrim i Përgjithshëm

Specialist *Spektori i Tatim –Taksave, kategoria -B*

Specialisti i tatim-taksave përgjigjet tek Përgjegjësi I Sektorit ,për menaxhimin e çështjeve që lidhen me regjistrimin e mases së detyrimeve të paguara nga subjektet private dhe institucionet shtetërore,plotesimin e evidences mujore dhe evidencen e përgjithshme mbi realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore,ushtrimin e kontrollit në terren për evidentimin e aktivitetit që ushtron subjekti,sipërfaqes së ndërtesës ku ushtrohet aktiviteti,evidentimin e subjekteve të reja si dhe atyre që mbyllin aktivitetin.

DETYRAT

Detyrat Kryesore

- a.** Të plotësojë regjistrin me masën e detyrimeve të paguara për taksat dhe tarifave vendore gjatë vitit nga subjektet private dhe institucionet shtetërore;
- b.** Plotëson dosjet personale të subjekteve me të gjitha të dhënat përkatëse çertifikatën e regjistrimit në organin tatimor, planimetrinë e objektit në të cilën ushtrohet aktiviteti, kopjen e formularit të fletënjoftimit për pagesën e taksave dhe tarifave vendore etj.
Plotëson formularin e fletënjoftimit për pagesën e taksave dhe tarifave vendore nga subjektet dhe institucionet;
- c.** Plotëson vërtetimin tip për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për subjektet e interesuara
- d.** Ushtron kontroll periodik në terren, në grup pune të caktuar nga përgjegjësi i sektorit të të ardhurave në bashkëpunim me Policinë Bashkiake për:
 - Evidentimin e llojit të aktivitetit që ushtron subjekti,
 - Evidentimin e sipërfaqeve të ndërtesave në të cilat ushtrohet aktivitet privat dhe publik,
 - Evidentimin e sipërfaqeve të reklamave të vendosura nga subjektet,
 - Evidentimin e subjekteve të reja që hapen gjatë vitit, të atyre që mbyllin aktivitetin dhe mban proces-verbale për rastet e evidentuara.
- e.** Plotëson evidencën mujore dhe evidencën e përgjithshme mbi realizimin e të ardhurave të grumbulluara nga taksat dhe tarifave vendore dhe bën hedhjen e të dhënave në kompjuter;
- f.** Raporton tek përgjegjësi i sektorit për kryerjen e detyrave të ngarkuara dhe problemet e evidentuara gjatë punës;
- g.** Mban ditarin e transportit, përgatit licencat, certifikatat dhe autorizimet për aktivitetin e subjekteve të transportit të mallrave dhe udhëtarëve;
- h.** Kryen edhe detyra të tjera operative që i caktohen nga përgjësia.
- i.** Ushtron kontroll ditor në terren sipas ndarjes zonale të qytetit të bërë nga përgj.sektori
- j.** Ndjekë në bashkëpunim me Policinë Bashkiake arkëtimin e debitorëve, pas plotësimit të fletënjoftimit të tatimit për të gjithë subjektet dhe institucionet, të cilët ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë.
- k.** Si dhe detyra të tjera që i ngarkohen nga përgjegjësi përkatës.



I. LEVIZJA PARALELE

Kjo procedurë është e hapur vetëm për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive në të gjitha institucionet, pjesë e shërbimit civil.

Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për lëvizjen paralele janë:

1. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar brenda të njëjtës kategori.
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
3. Të ketë të paktën vlerësim e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.

Kriteret e vecanta për këtë pozicion janë:

- a. Të zotëroje Diplomë të Nivelit të Parë, “Bachelor” në degët : shkencat ekonomike/administrative . Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- b. Të ketë të paktën 1 vit punë
- c. Të ketë njohuri të një gjuhe të huaj;

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë **me postë**, në zyrën e **Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njërëzore**, të Bashkisë Mallakastër, këto dokumenta:
dokumentat si më poshtë:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
2. Një kopje të jetëshkrimit (CV).
3. Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
4. Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njehsuar pranë Ministrisë së Arsimit.
5. Fotokopje e diplomës me listën e notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
6. Fotokopje e vlerësimit të fundit vjetor.
7. Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
8. Certifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
9. Fotokopje e letërnjoftimit (karte Identiteti).
10. Vërtetim te gjendjes gjyqësore dhe shëndetësore.(Dëshmi penaliteti dhe raport mjekësor).

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë brenda datës 23.01.2017.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK



Në datën **24 /01 / 2017, Njësia** e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mallakastër do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar të Punësimit", në faqen zyrtare të Internetit të Bashkisë në stendën e informimit të publikut., listën paraprake të kandidatëve që **do të vazhdojnë konkurimin**, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë **kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta** do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mallakastër, për shkaqet e moskualifikimit në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së verifikimit paraprak të kandidatëve në rrugë elektronike përmes emailit të paraqitur nga kandidati në dokumentacionin e aplikimit.

Ankesat nga kandidatet paraqiten në Njësinë Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore **brenda 5 ditëve kalendarike.(24.01.2017-28.01.2017) dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 kalendarike nga data e depozitimit të saj(24.01.2017-01.02.2017)**

Në datë **02.02.2017**, Njësia e Burimeve Njerëzore, shpall listën e verifikimit përfundimtar të kandidatëve si dhe datën dhe vendin e saktë se ku do të zhvillohet konkurrimi Konkurrimi intervista e strukturuar me gojë, do të zhvillohet në ambientet e Zyrës së Burimeve Njerëzore, në Bashkinë Mallakastër më datë **03.02.2017 ora 09:00**

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Në intervistë kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr.139/2015 "Për vetqeverisjen Vendore"
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike"
- Ligji nr152/2013, për nëpunësin civil I ndryshuar
- Ligj Nr. 142/2015 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Ligjin Nr. 9632, Datë 30.10.2006, "Për Sistemin E Taksave Vendore", Të Ndryshuar
- Ligj Nr.9632, Datë 30.10.2006, "Për Sistemin E Taksave Vendore",I Ndryshuar.
- Ligj Nr.9920, datë 19.5.2008 Për Procedurat Tatimore Në Republikën E Shqipërisë

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT



Komisioni, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve) në rast të kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohet parashikimi i pikës 13, të Kreut IV të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243 dt.18.03.2015

Komisioni më datë **03.02.2017** njofton për vendimin e përzgjedhjes, Njësinë Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Njësia Përgjegjëse e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, me datë **03.02.2017** shpall fituesin.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në

- në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”,
- në faqen zyrtare të Bashkisë Mallakastër
- stendën e publikimeve të Bashkisë Mallakastër

Në të njëjtën ditë (**datë 03.02.2017**, NJMB njofton të gjithë aplikantët që nuk rezultojnë fitues. Kandidatët pavarësisht nga e drejta për tu ankuar në Gjykatë administrative kanë të drejtë të bëjnë ankesë me shkrim pranë KPP brenda **5 ditëve** kalendarike nga data e marrjes së ankimimit (nga **data 03-02.2017- 07.02.2017**). Komiteti shqyrton ankimimin dhe kthen përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e marrjes së ankesës. (**07.02.2017- 11.02.2017**). Në datë **12.02.2017**, NJMB fton kandidatët të përzgjedhin pozicionet sipas renditjes së rezultateve.

2

PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.

Kriteret e veçanta për këtë pozicion janë:



1. Të zotëroje Diplomë të Nivelit të Parë, “Bachelor” në degët : shkencat ekonomike/admistrative . Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Të zotërojw njw gjuhë t'whuaj (e certifikuar)

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë Kandidati duhet të dërgojë me postë në Zyrën e Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të Bashkisë Mallakastër, këto dokumenta:

1. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://ëëë.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
2. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;;
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID); ;
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
6. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;;
7. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
8. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë brenda datës 27.01.2017, në adresë të Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Bashkinë Mallakastër.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **28.01.2017 NJBNJ** do të shpallë në portalin ”Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e Internetit të Bashkisë Mallakastër dhe në standin e informimit të publikut, **listën paraprake të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin**, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë **kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive** dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Njësia Përgjegjëse e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për shkaqet e moskualifikimit., në rrugë elektronike nëpërmjet emailit.

Ankesat nga kandidatet paraqiten në Njësia Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore brenda 5 ditëve kalendarike dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 diteve kalendarike nga data e depozitimit të saj. **(28.01.2017- 05.02.2017).**

Në datë **06.02.2017** do të publikohet lista përfundimtare e kandidatëve që vazhdojnë konkurrimin.

Konkurimi me shkrim do të zhvillohet në ambientet e shkollës “Besëlidhja” Ballsh më datë **07.02.2017 ora 09:00.**

Në datë 07.02.2017, ora 12:00 NJMB do të shpallë rezultatet e konkurrimit me shkrim.



Intervista e strukturuar me gojë, do të zhvillohet në ambjentet e Zyrës së Burimeve Njerëzore, në Bashkinë Mallakastër më datë **07.02.2016 ora 14:00.**

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

- **Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:**
 - Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
 - Ligji nr.139/2015 “Për vetqeverisjen Vendore”
 - Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike
 - Ligji nr152/2013, për nëpunësin civil I ndryshuar
 - Ligj Nr. 142/2015 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Ligjin Nr. 9632, Datë 30.10.2006, "Për Sistemin E Taksave Vendore", Të Ndryshuar
 - Ligj Nr.9632, Datë 30.10.2006, "Për Sistemin E Taksave Vendore",I Ndryshuar.
 - Ligj Nr.9920, datë 19.5.2008 Për Procedurat Tatimore Në Republikën E Shqipërisë

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen nga **Komiteti i Përhershëm i Pranimit**, i ngritur pranë Bashkisë Mallakastër.Totali i pikeve të vlerësimit të kandidateve është 100 pike te cilat ndahen përkatësisht:

- a. 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

Komiteti i Përhershëm i Pranimit, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin “

Specialist <i>Spektori i Tatim –Taksave</i> , kategoria IV-B	1 (një)
---------------------------------------------------------------------	---------

Në rast se dalin fitues më shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 13, të kreut IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë, 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorin ekzekutive”.

Komiteti i Përhershëm i Pranimit brenda 24 (njëzet e katër) orëve, vendos në dispozicion listën e fituesve, Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

(Një pozicion) - Specialist i Sektorit të Auditit të Brendshëm, kategoria: IV-B

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, shpall listën e fituesve **08.02.2017.**



Njoftimi do të bëhet:

- në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”
- në faqen zyrtare të Bashkisë Mallakastër
- në stenden e informimit publik të Bashkisë Mallakastër.

Kandidatët që nuk rezultojnë fitues kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim në KPP për rezultatin e pikëve Brenda **5 ditëve kalendarike nga marra e njoftimit(08.02.2017-12.02.2017)**. Ankuesi merr përgjigje Brenda **5 ditëve kalendarike nga data e ankesës. (08.02.2017-16.02.2017)**

Në datë 17.02.2017 NJMB do të ftojë kandidatët fitues për të përzgjedhur pozicionet ku kanë rezultuar fitues.

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni ne :

e-mail : ezenelaj@bashkiamallakaster@gov.al

nr.tel: 0695420184

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE
BASHKIA MALLAKASTËR
ENGJËLLUSHE ZENELAJ